



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:131300

Datë: 17.03.2021

Numri i dokumentit: 01604210

PKR.nr.228/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit P. Z. nga fsh.K-....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.158/20 të dt.16.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Haxhi Sinani, të akuzuarit P. Z. , me dt. 15.03.2021, mori dhe me dt.17.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

P. Z. , i biri i N. dhe nenës L. e gjinisë N., me banim ne fshatinK-, i lindur me dt., i martuar, babe i gjashte fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, me profesion mirëmbajtës ne shkolle , posedon nr. tele. , i gjendjes së mesme ekonomike, nr. personal , Serbe Shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 30.06.2020, rreth orës 08:00, në fsh., K., pikërisht në shtëpinë e tij , në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët përkatësisht nenin , mbanë në pronësi armë , në atë mënyrë që me datën e lartcekur është zbatuar kontrolli në shtëpinë e tij, me ç ‘rast në dhomën e pritjes nën krevat, i është gjetur dhe konfiskuar 1(një) pistoletë e llojit TT, cal. 7.62mm, prodhim jugosllav, pa shënime tjera dhe 1(një) karikator i zbrazët i të njëjtës pistoletë, e për të cilat nuk posedon leje përkatëse,

-Me çka ka kryer veprë penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Andaj , gjykata konform nenit 7,38,39,40,43,69, 70 të KPRK-së, nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3(tre)muajsh, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Të akuzuarit i konfiskohet 1(një) pistoletë e llojit TT, cal. 7.62mm, prodhim jugosllav, pa shënime tjera dhe 1(një) karikator i zbrazët i të njëjtës pistoletë, që gjendet në zengjinin e ruajtjes sipas rastit policorë 2020-DF-318 dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€, si dhe shumën 50€ në emër të viktimave, në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.158/20 të dt. 15.10.2020, kundër të akuzuarit P. Z. nga fsh.....K-....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 15.03.2021, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari P. Z. ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin duke u gjendur para pranimit të fajësisë dhe provave në shkresa të lëndës siç janë: Raporti i oficerit M. T. #9810, i përpiluar nën nr. të rastit : 2020-

DF-317, dt. 30.06.2020; Deklarata e të dyshuarit P. Z., e dhënë pranë stacionit Policor–Njësitit të Hetimeve –Istog, me dt.30.06.2020, Dëftesa mbi konfiskimin e armëve, nga i dyshuari P. Z., nën nr. të rastit 2020-DF-317 dt. 30.06.2020, Lista e dëshmimeve, e përpiluar nën nr. të rastit 2020-DF-317, dt. 30.06.2020, ku me numrat përkatës janë evidentuar sendet e konfiskuara, Fotografi e armës së gjetur dhe të konfiskuar, Procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë së të dyshuarit P. Z. i dt. 30.06.2020, deklarata e të pandehurit P. Z. e dhënë në prokurori me dt.15.10.2020, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është mbajtës i familjes, premtion se nuk do të përsëriten veprime të tilla. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Konform nenin 366 par 3 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet arma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2020:131300, 17.03.2021

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.